



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.10

2005

16 mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.173, datë 24.2.2005	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Shërbimit Civil.....	425
Vendim i Kuvendit nr.174, datë 24.2.2005	Për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Letrave me Vlerë...	425
Vendim i Kuvendit nr.175, datë 24.2.2005	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e dy anëtarëve të Gjykatës së Lartë.....	426
Vendim i KM nr.100, datë 18.2.2005	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kthesa e Shëngjinit–Ura e Re, Lezhë”.....	427
Vendim i KM nr.102, datë 18.2.2005	Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për vitin 2005.....	429
Vendim i KM nr.104, datë 18.2.2005	Për miratimin e marrëveshjes “Për bashkëpunimin në fushën e turizmit”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë e Malit të Zi.....	429

Vendim i KM nr.105, datë 18.2.2005	Për një shtesë në vendimin nr.148, datë 31.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e shitjes së mallrave, të ardhura grant nga Japonia, në kuadër të projektit “Shtimi i prodhimeve ushqimore”, 2KR”.....	432
Vendim i KM nr.107, datë 25.2.2005	Për një shtesë në vendimin nr.596, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij” dhe për një ndryshim në vendimin nr.390, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen objekteve të rëndësisë së veçantë me forcat e Policisë së Shtetit”...	433
Vendim i KM nr.108, datë 11.2.2005	Për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.....	436
Vendim i KM nr.109, datë 25.2.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	438
Vendim i KM nr.111, datë 25.2.2005	Për dhënie fondi ndihme partisë “Lëvizja Sociale për Integrim”...	439
Vendim i KM nr.115, datë 25.2.2005	Për krijimin e Autoritetit Shtetëror të Sigurisë Portuale.....	439
Vendim i KM nr.119, datë 25.2.2005	Për krijimin e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Dibrës.....	440
Vendim i KM nr.120, datë 25.2.2005	Për krijimin e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Kukësit.....	441
Vendim i KM nr.121, datë 25.2.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, të ndryshuar.....	442
Udhëzim i KM nr.1, datë 22.2.2005	Për disa shtesa në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.....	443
Udhëzim i ME nr.68, datë 15.3.2005	Për një shtesë në udhëzimin nr.1, datë 9.5.2003 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedurat e shitjes”.....	444

VENDIM
Nr.173, datë 24.2.2005

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Mimoza Hysenaj zgjidhet në detyrën e anëtares së Komisionit të Shërbimit Civil.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.174, datë 24.2.2005

PËR ZGJEDHJEN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË LETRAVE ME VLERË

Në mbështetje të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 3 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, i ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Ksenofon Krisafi zgjidhet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.
- II. Zoti Përparim Kalo zgjidhet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.175, datë 24.2.2005

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E DY ANËTARËVE TË GJYKATËS
SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, bazuar në dekretet e Presidentit të Republikës nr.4481, datë 17.2.2005 dhe nr.4482, datë 17.2.2005,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Jepet pëlqimi për emërimin e zotërinjve Ardian Dvorani dhe Besnik Ymeraj në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

**VENDIM
Nr.100, datë 18.2.2005**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “KTHESA E SHËNGJINIT-URA E RE, LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kthesa e Shëngjinit-Ura e re, Lezhë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen tokë truall 1149 m², me vlerë 1 818 867 (një milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, objekte me sip.552,3 m², me vlerë 29 925 628 (njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekë, dru frutorë 155 copë, me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) lekë, me vlerë të përgjithshme 32 244 497 (tridhjetë e dy milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale janë në vlerën 227 296 (dyqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 32 471 793 (tridhjetë e dy milionë e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 1.4.2005.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU LEZHE

Lista e pronareve qe preken nga ndertimi i segmentit rrugor " Kthesa e Shengjinit - Ura e re Lezhe "

Lloji i pasurise se paluajtshme: Truall, objekte dhe dru frutore

Nr	Emer	Atesia	Mbiemri	Nr. pas.	Sip,m2	Truall l/m2	Vlera leke	Sip.m2	Objekte preventiv	Vlera leke	Dru frutore cope	leke	Vlera Totale leke	Shenime
	Prek	Nikoll	Ivanaj											
	Fize	Nikoll	Ivanaj											
1	Mark	Nikoll	Ivanaj	1/10,	592	1563	937136						937136	
	Ndue	Nikoll	Ivanaj											
	Luigj	Nikoll	Ivanaj											
	Mara	Nikoll	Ivanaj											
	Prenda	Nikoll	Ivanaj											
	Prek	Nikoll	Ivanaj											
	File	Nikoll	Ivanaj											
	Mark	Nikoll	Ivanaj											
2	Ndue	Nikoll	Ivanaj	1/24,	131	1563	207373						207373	
	Luigj	Nikoll	Ivanaj											
	Mara	Nikoll	Ivanaj											
	Prenda	Nikoll	Ivanaj											
3	Pashk	Ndoc	Matia	8/102									3869124	
4	Lumturije	Pjedrushi		8/132				80	amort 6%	3869124			3509503	
5	Shfaqet		Nika	13/63,				74	amort 8%	3509503			130000	
6	Gjergj	Mark	Prenga	10/56,				32		130000			160000	
7	Gjon	Nikoll	Gjoka	10/56,				20		160000			2000000	
8	Marselin	Hil	Ndreca	13/84,				41.8		2000000			14257001	
9	Gjok	Gjon	Ndoka	9/39,	137	1563	216871	181.5	amort. 3%	14257001			3216871	
	Lace		Salih					63		3000000				
10	Lumnije	Vehbi	Salih	8/100,				60		3000000			3000000	
	Izet	Vehbi	Salih											
	Adelina	Vehbi	Salih											

11	Luigj	Kol	Gjoka	8/133	160	1583	253280						253280	
12	Luigj	Kol	Gjoka	8/134	94	1583	148802						148802	
13	Gjergj	Kol	Gjoka	8/131	35	1583	55405						55405	
14	Lazer	Luk	Marku	132/13						60	210000		210000	konfir nga komuna
15	Ramadan	Qamil	Osja	42/11						95	290000		290000	konfir nga komuna
		Totali			1149	1583	1818867	552.3		29925628	155	500000	32244495	

Shpenzime procedurale leke 227 296
Vlera totale e shpronesimit leke 32 471 793

VENDIM
Nr.102, datë 18.2.2005

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për

telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2005, në shumën 251 976 571 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

**STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR
TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2005**

Nr.	Emërtimi	Lekë
	Shpenzime gjithsej:	251 976 571
1	Paga	39 476 571
2	Kontributi i sigurimeve shoqërore	7 200 000
3	Materiale	4 700 000
4	Shërbime	20 800 000
5	Investime	179 800 000

VENDIM
Nr.104, datë 18.2.2005

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES “PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E
TURIZMIT”, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SERBISË E MALIT TË ZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “d”, dhe 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes “Për bashkëpunimin në fushën e turizmit”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë e Malit të Zi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**MARRËVESHJE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SERBISË DHE MALIT TË ZI PËR BASHKËPUNIM NË
FUSHËN E TURIZMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Serbisë dhe Malit të Zi, të emëruara si Palët,

me dëshirën për të zhvilluar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin në fushën e turizmit ndërmjet të dy vendeve;

duke identifikuar interesin e përbashkët në sigurimin e një kuadri ligjor të përshtatshëm dhe

afatgjatë për bashkëpunim në fushën e turizmit;

të drejtuar nga parimet dhe rekomandimet e Konferencës për Turizmin dhe Udhëtimet Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Manila 1980, Aktit Përfundimtar të Konferencës mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë, Helsinki 1975, dhe duke iu përmbajtur rekomandimeve të Organizatës Botërore të Turizmit,

ranë dakord për sa vijon:

Neni 1

Palët, duke respektuar legjislacionin kombëtar në fuqi, do të mbështesin dhe zhvillojnë marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet organeve kompetente shtetërore, enteve ekonomike, organizatave, shoqatave dhe institucioneve turistike në të dy vendet, si dhe do të marrin masa në këtë drejtim.

Palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi në të dy vendet, do të lehtësojnë formalitetet e udhëtimit, si dhe procedurat e kontrollit kufitar me qëllim rritjen e shkëmbimit turistik ndërmjet dy vendeve.

Neni 2

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e dyanshëm të të dhënave dhe informacioneve në fushën e turizmit, trajnimeve, studimeve dhe projekte kërkimi në turizëm.

Palët, në përputhje me legjislacionet kombëtare dhe brenda kompetencave të tyre, do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet organeve dhe organizatave kompetente në fushën e trajnimit dhe shkëmbimin e ekspertëve në turizëm.

Neni 3

Palët do të shikojnë mundësinë e organizimit të kurseve të trajnimit për menaxherët e institucioneve turistike, hoteleve dhe industrisë së shërbimeve, si dhe të specialistëve të marketingut dhe promovimit të turizmit.

Neni 4

Palët do të lehtësojnë shkëmbimin e materialeve promociionale për prezantime turistike, si dhe do të inkurajojnë subjektet turistike të marrin pjesë në aktivitetet turistike që zhvillohen në vendin e Palës tjetër.

Neni 5

Palët do të inkurajojnë dhe do të mbështesin organizimin e vizitave studimore për korrespondentë të medias dhe ekspertë turistikë.

Palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendet e tyre përkatëse, do të inkurajojnë organizimin e ekspozitave, prezantimeve të filmave turistikë me qëllim prezantimin e ofertave të tyre turistike.

Neni 6

Palët do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zhvillimit dhe përmirësimit të ofertës turistike dhe shkëmbimit të informacionit me qëllim përpunimin dhe zbatimin e projekteve me interes të përbashkët, si dhe *joint ventur*-ës. Palët gjithashtu do të inkurajojnë dhe mbështesin shkëmbimin e ekspertizës në fushën e turizmit.

Palët do të inkurajojnë organizimin e takimeve ndërmjet kompanive turistike, specialistëve dhe njerëz të biznesit me qëllim sigurimin e mundësive për prezantimin e informacionit, statistikave, dokumenteve dhe projekteve të propozuara të investimit kapital në fushën e turizmit.

Neni 7

Palët do të koordinojnë bashkëpunimin e autoriteteve dhe organizatave të tyre turistike, duke u bazuar në dispozitat e Organizatës Botërore të Turizmit dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Neni 8

Palët do të informojnë njëra-tjetrën për të gjitha dokumentet ndërkombëtare në fushën e turizmit në të cilat Palët aderojnë dhe që kanë impakt mbi bashkëpunimin ndërmjet Palëve.

Neni 9

Palët, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në secilin prej dy vendeve, do të lehtësojnë krijimin e qendrave informuese kombëtare për turizmin në territorin e Palës tjetër dhe do të ndihmojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për organizimin dhe kryerjen e aktiviteteve të tyre.

Neni 10

Me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord të krijojnë Komisionin e Përbashkët për turizmin, i cili do të jetë i përbërë nga një numër i njëjtë përfaqësuesish nga të dyja palët.

Neni 11

Komisioni i Përbashkët për turizmin do të mbledhet të paktën një herë në vit dhe, nëse është e nevojshme, disa herë në vit në mënyrë alternative në territorin e Palëve.

Komisioni i Përbashkët:

- do të sigurojë zbatimin e Marrëveshjes;
- do të monitorojë dhe analizojë rezultatet e bashkëpunimit;
- do të sigurojë shkëmbimin e informacionit mbi çdo ndryshim të rregulloreve turistike në secilin nga vendet e Palëve;
- do të propozojë aktivitete konkrete dhe forma të tjera bashkëpunimi të ndërsjellë në të ardhmen.

Neni 12

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit përfundimtar me anën e të cilit Palët informojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për pesë vjet dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë tjetër pesëvjeçare, nëse asnjëra nga Palët nuk njofton Palën tjetër për qëllimin e saj për ndërprerjen e Marrëveshjes 6 muaj përpara datës së përfundimit të saj.

Shfuqizimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ketë efekt në zbatimin e ndonjë programi apo projekti të miratuar gjatë kohës që Marrëveshja ishte në fuqi, përveç kur Palët nuk vendosin ndryshe.

Bërë në Tiranë, më 22.12.2004 në dy ekzemplarë origjinalë, në gjuhën shqipe, serbe dhe atë angleze, të gjithë tekstet janë njësoj të vërtetë.

Në rast mospërputhje mbi interpretimin e Marrëveshjes do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

VENDIM

Nr.105, datë 18.2.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.148, DATË 31.3.2000 TË KËSHILLIT TË

MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E SHITJES SË MALLRAVE, TË ARDHURA GRANT NGA JAPONIA, NË KUADËR TË PROJEKTIT “SHTIMI I PRODHIMEVE USHQIMORE”, 2KR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 2 të vendimit nr.148, datë 31.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të marrë përsipër shërbimin teknik të mjeteve të mekanikës bujqësore, që do të shiten me këste, për të gjithë periudhën deri në shlyerjen përfundimtare të tyre nga përdoruesit. Ky shërbim të realizohet sipas procedurave ligjore, nëpërmjet kontraktimit me subjektet, që kryejnë këto shërbime, të përzgjedhura me tender të hapur. Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit teknik të përdoret fondi kundërparti, në masën 10 për qind, i arkëtuar nga përfituesit e traktorëve 50 KF e të makinerive bujqësore, dhe në masën 5 për qind, i arkëtuar nga përfituesit e traktorëve mbi 50 KF dhe të kombajnave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.107, datë 25.2.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.596, DATË 10.9.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AUTORITETIT PORTUAL Durrës DHE PËR RIORGANIZIMIN E TIJ” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.390, DATE 15.8.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MBROJTJEN OBJEKTEVE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË ME FORCAT E POLICISË SË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në statutin e Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimin nr.596, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave, pas nenit 18, shtohet neni 19, me përmbajtje sipas anekseve 1, 1/1 dhe 1/2, që i

bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.390, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave, emërtimi me nr.2 “Porti Detar Durrës”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKSI 1

Neni 19

Shërbimi i sigurisë në anije dhe në port

1. Forca e sigurisë në anijet dhe në portin e Durrësit (FSAP), në varësi të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës, organizohet sipas strukturës, e cila i bashkëlidhet këtij statuti, aneksi 1/1.

Autoriteti Portual Durrës, në varësi të rritjes së vëllimit të punës, ka të drejtë të rrisë ose të pakësojë numrin e punonjësve të FSAP-së, por pa ndryshuar strukturën.

2. FSAP-ja e zhvillon veprimtarinë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Porteve, të Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), me konventën SOLAS, 74, të ndryshuar me ligjin nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, dhe me aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Kjo forcë sigurie ka për detyrë:

a) Mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, të objekteve dhe vlerave të portit.

b) Krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të përshtatshëm për Autoritetin Portual Durrës dhe operatorët e ndryshëm, që veprojnë në këtë port, për një punë 24-orëshe (me tre turne).

3. Drejtori i FSAP-së, në Durrës, është në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës dhe përgjigjet para tij për të gjithë veprimtarinë e sigurisë në port dhe në anijet e ankoruara, në lëvizje nga/dhe në drejtim të portit, në radë, si dhe vepron në përputhje me udhëzimet e drejtorit ekzekutiv.

4. Kriteret profesionale për përzgjedhjen (rekurtimin) e anëtarëve të FSAP-së përcaktohet nga Autoriteti Portual Durrës dhe miratohen nga Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit.

5. FSAP-ja është pajisur me armatimin dhe mjetet e nevojshme, për të siguruar mbrojtjen e portit dhe të anijeve nga çdo sulm i mundshëm, terrorist a keqbërës, apo nga hyrja, në mënyrë të kundërligjshme, e shtetasve dhe e mjeteve në zonën, që ka objekt kontrolli. Pajisjet, mjetet dhe armatimi i lejuar përcaktohen në aneksin 1/2, që i bashkëlidhet statutit.

6. FSAP-ja kur, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, vëren kryerjen e një vepre penale, siguron vendin e ngjarjes, provat materiale, ndalon autorët dhe njofton strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit e prokurorisë dhe bashkëvepron me ta për vazhdimin e procedimit penal.

Gjithashtu, FSAP-ja kur vëren shkelje apo shmangie nga detyrimet doganore, i raporton menjëherë degës së doganave, Durrës.

7. Komiteti i Sigurisë në anijet dhe në portin e Durrësit është organ kolegjal dhe kanë përbërje:

- | | |
|---|----------|
| - Drejtorin Ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës | kryetar; |
| - Një përfaqësues të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë | anëtar; |
| - Një përfaqësues të Drejtorisë së Transportit Detar | anëtar; |
| - Një përfaqësues të këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës | anëtar; |
| - Kapitenin e Përgjithshëm të porteve | anëtar; |
| - Një përfaqësues të Ministrisë së Rendit Publik | anëtar; |
| - Një përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes | anëtar; |
| - Një përfaqësues të Ministrisë së Financave | anëtar. |


8. Ky Komitet vlerëson projektplanin e sigurisë dhe bashkërendon punën me palët operuese në port, për zbatimin e këtyre planeve. Komiteti i Sigurisë mbledhet një herë në tre muaj, por, me kërkesë të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë apo të Autoritetit Portual Durrës, mund të mbledhet edhe më shpesh.

9. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës, në përputhje me ligjin nr.9281, datë 23.9.2004

“Për sigurinë në anije dhe porte”, miraton rregulloren e brendshme për funksionimin e FSAP-së.

FORÇA E SIGURIMIT E PORTIT TE DURRESIT

Aneksi 1/1



SHENIME:

- Drejtori i Forces se Sigurimit te Portit i jep llogari drejtperdrejt Drejtorit te Autoritetit Portual.
- Shefat e turneve mund te jene neninspektore, inspektore ose kryeinspektore.
- Nje agjent nga secili turn do te emerohet zevendes i shefit te turnit.

Aneksi 1/2

PAJISJE E FORCËS SË SIGURISË

Përshkrim

ARMË

Pistoleta

Shkop zgjatues dhe mbajtës

TRANSPORT

4 mjete foristradë

Mjet lundrues patrullues

NDËRLIDHJE

Radio stacionare VHF

Radio dore VHF

Karikues baterish

Bateri rezervë

UNIFORMA

Verore/dimërore++

VENDIM

Nr.108, datë 11.2.2005

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIMIT DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), si institucion qendror, buxhetor, në varësi të Ministrit të Financave. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave e ushtron veprimtarinë me qëllim parandalimin dhe luftën kundër krimit në fushën e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit e krimit financiar, në përgjithësi.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave kryhen funksionet e njësisë së informacionit financiar. Ajo shërben si qendër kombëtare dhe është përgjegjëse për mbledhjen, kërkimin, për aq sa lejohet nga ligji, analizimin dhe shpërndarjen autoriteteve kompetente të të dhënave për dyshime për pastrim parash dhe financim të mundshëm të terrorizmit, mbështetur në legjislacionin shqiptar në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave përgjigjet për bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërkombëtar të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të përcaktuara nga grupi ndërkombëtar kundër zbardhjes së kapitaleve GAFI-FATF, direktivat nr.308 e vitit 1991 dhe nr.97 e vitit 2001 të Bashkimit Europian, konventat e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (Konventa e Palermos) dhe kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike e lëndëve psikotrope (Konventa e Vjenës e vitit 1988), konventën e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit të vitit 1999, si dhe rezolutat e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave zbaton standardet ndërkombëtare për ruajtjen e bazës së të dhënave nga çdo përdorim i paautorizuar dhe nga ndikimet

politike.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, si njësi e informacionit financiar, ka këto detyra:

a) Bashkëpunon me institucionet e tjera për përmirësimin e legjislacionit në fushën e krimit ekonomik, për arritjen e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimit financiar dhe korrupsionit;

b) Merr masa për mbledhjen, ruajtjen dhe administrimin e të dhënave dhe bashkëpunon me institucione të tjera, vendase a të huaja, për të siguruar ushtrimin e veprimtarisë së saj;

c) Bashkëpunon me organet e prokurorisë, me Ministrinë e Rendit Publik, Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit, Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale, Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Autoritetin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Bankën e Shqipërisë, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Agjencinë Kombëtare të Privatizimit për përcaktimin e rregullave të hollësishme procedurale për shkëmbimin e të dhënave, ruajtjen e burimit të tyre nga bërja publike dhe për zbatimin e legjislacionit në fuqi;

ç) Bashkëpunon me institucionet e tjera për shmangien e ushtrimit të veprimtarive të palicencuara;

d) Zbaton detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, për të shkëmbyer të dhëna, për zhvillimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

dh) Nënshkruan marrëveshje teknike me njësi dhe struktura simotra, agjenci partnere në vende të tjera, që kryejnë funksione të ngjashme dhe që janë subjekt i detyrimit të ruajtjes së sekretit, në zbatim të pikës 6 të nenit 15 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të ndryshuar;

e) Përgatit raportin vjetor të veprimtarisë, të cilin ia paraqet Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave dhe institucioneve të tjera, që kryejnë funksione të ngjashme ose që kanë lidhje me luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ë) Zhvillon sisteme të pavarura të teknologjisë së informacionit dhe merr masa për ruajtjen dhe sigurinë për moslejimin e ndërhyrjes në këto sisteme të personave të paautorizuar.

6. Kriteret e veçanta për marrjen në punë të personelit dhe deklarimin e pasurisë së kategorisë së punonjësve, të cilët nuk parashikohen nga ligji për deklarimin e pasurisë, për vetë natyrën dhe kushtet e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

7. Pagat e specialistëve deri te Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave përcaktohen sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7.1. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes 1 – Diplomë e shkollës së lartë është 9306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë.

7.2. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 3) e lidhjes 1, jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

7.3. Shtesat për kualifikim (kolona 4) e lidhjes 1 është 0.

7.4. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5 të lidhjes 1.

8. Pozicionet “drejtor i përgjithshëm” dhe “zëvendësdrejtor i përgjithshëm” përfitojnë një shtesë, për kushte pune, në masën 12 000 lekë në muaj. Pozicionet “përgjegjës sektori” dhe “specialist” në Drejtorinë e Analizës dhe Drejtorinë e Inspektimit përfitojnë një shtesë, për kushte pune, në masën 15 000 lekë në muaj.

9. Pagat e punonjësve të tjerë të drejtorisë përcaktohen sipas lidhjes II-5 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

10. Punonjësit aktualë të Drejtorisë së Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave të kalojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

11. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës, në zbatim të pikës 6 të këtij vendimi.

12. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

Emërtimi	Kategoritë	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		Paga e grupit	Shtesa vjetore për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	9 306	2%	0	93 060
Zv. Drejtor i Përgjithshëm	II-b	9 306	2%	0	76 516
Drejtor	III-a/1	9 306	2%	0	47 564
Përgjegjës sektori	III-b	9 306	2%	0	41 360
Specialist	IV-a	9 306	2%	0	31 020
Specialist	IV-b	9 306	2%	0	20 680

VENDIM
Nr.109, datë 25.2.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar t’i shtohen dhe “18 km” rrugë.
2. Në lidhjen 1 “Rrjeti rrugor kombëtar”, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet emërtimi:

“Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Elbasan, Gostim-Klos-Mollas-Selitë, 18 km rrugë interurbane, dytësore”.

3. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale”, që i bashkëlidhet vendimit, hiqet emërtimi “Gostim-Klos-Mollas-Selitë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.111, datë 25.2.2005

PËR DHËNIE FONDI NDIHME PARTISË “LËVIZJA SOCIALE PËR INTEGRIM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim” t’i jepet fondi prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.115, datë 25.2.2005

PËR KRIJIMIN E AUTORITETIT SHTETËROR TË SIGURISË PORTUALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24 e 36 të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Autoritetit Shtetëror të Sigurisë Portuale, në varësi të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, brenda strukturës së Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
 2. Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale shqyrton planet e sigurisë së porteve dhe ia paraqet për miratim Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit.
 3. Autoriteti ka si objekte kryesore të veprimtarisë së tij:
 - a) Shqyrtimin dhe përgatitjen për miratim të një plani sigurie për operatorët, të cilët veprojnë në transportin detar;
 - b) Përcaktimin e kërkesave për një deklaratë sigurie;
 - c) Kaktimin e nivelit të sigurisë, që do të zbatohet në infrastrukturën portuale dhe në anije;
 - ç) Kontrollin e zbatimit të planit të sigurisë dhe të operatorëve, që veprojnë në transportin detar.
 4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.119, datë 25.2.2005

PËR KRIJIMIN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Dibrës, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:

2.1 Zona e fushës së Dibrës, në Fushë Aliaj-Kastriot-Maqellarë-Arras-Zall-Dardhë, që kullon një sipërfaqe prej 1500 ha;

2.2 Zona e fushës së Matit, që kullon një sipërfaqe prej 1200 ha;

2.3 Zona e fushës në Bulqizë, në Gjoricë, që kullon një sipërfaqe prej 600 ha;

2.4 Zona e fushës së Bulqizës, që kullon një sipërfaqe prej 200 ha;

2.5 Pendet mbrojtëse nga përmytja e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

2.6 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, që janë brenda fushave të sistemuara.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje, me 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.120, datë 25.2.2005

PËR KRIJIMIN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Kukësit, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:

2.1 Zona e fushës së Kukësit, në Shtiqën-Gostil-Bicaj-Nangë, që kullon një sipërfaqe prej 1200 ha;

2.2 Zona e fushës së Hasit, në Llakaj-Lataj-Fajzë, që kullon një sipërfaqe prej 500 ha;

2.3 Zona e fushës në Tropojë-Cernicë-Zogaj-Tëpla-Pac, që kullon në sipërfaqe prej 1400 ha;

2.4 Pendet mbrojtëse nga përmbytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

2.5 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, që janë brenda fushave të sistemuara.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje, me 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.121, datë 25.2.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.540, DATË 21.12.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KËSHILLAVE TË KULTURËS DHE SHPËRBLIMIN E TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8445, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.450, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet si më poshtë vijon:

“PËR KRIJIMIN E KËSHILLAVE ARTISTIKO-KULTURORE DHE PËR SHPËRBLIMIN

E ANËTARËVE TË TYRE”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Krijimin e këshillave artistiko-kulturore, pranë Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, institucioneve qendrore kulturore, artistike dhe atyre të trashëgimisë kulturore, si dhe pranë bashkive a komunave, me karakter këshillimor, me mandat 2–vjeçar.

Përbërja e këshillit artistiko-kulturore pranë Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve caktohet me urdhër të tij.

Përbërja e këshillit artistiko-kulturore pranë institucioneve qendrore me karakter artistik, kulturor dhe të trashëgimisë kulturore miratohet nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas propozimit të titullarëve të këtyre institucioneve.

Përbërja e këshillit artistiko-kulturore në bashki a komunë miratohet nga këshilli i bashkisë a komunës përkatëse.

Funksionimi i këtyre këshillave bëhet në përputhje me rregulloren e miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me propozimin e vetë këshillit.

Pranë institucioneve të përmendura më sipër krijohen edhe këshilla të përkohshme artistiko-kulturore, të cilat funksionojnë si juri apo komisione të vlerësimit të veprave të artit.”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Këshillat artistiko-kulturore të kenë në përbërje personalitete të shquara në fushën e artit, të kulturës dhe të shkencës, të cilët nuk duhet të jenë të punësuar në institucionet pranë të cilave janë ngritur këto këshilla.”.

4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Këshillat artistiko-kulturore propozojnë dhe japin mendime për hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore e artistike të institucioneve pranë të cilave funksionojnë, për mbështetjen e talenteve të reja dhe vlerësimin e cilësisë artistike etj.

Për probleme të veçanta, me karakter profesional, si dhe për kalendarin vjetor të veprimtarive, që do të zhvillohen nga institucionet, këshillat artistiko-kulturore kanë të drejtë vendimmarrëse.

Për kalendarin vjetor të veprimtarive njoftohet Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për institucionet qendrore në varësi të tij, kryetari i bashkisë për bashkinë dhe kryetari i komunës për komunën, sipas propozimeve të këshillave artistiko-kulturore.”.

5. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Anëtarët e këshillave artistiko-kulturore, pranë Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe institucioneve qendrore kulturore, artistike dhe atyre të trashëgimisë kulturore, të shpërblehen, në masën 4 500 (katër mijë e pesëqind) lekë, çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje, ndërsa anëtarët e këshillave në bashki a komunë, të shpërblehen sipas vendimit të këshillit të bashkisë a komunës, por jo më tepër se 4 500 (katër mijë e pesëqind) lekë, çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje.

Të drejtën e shpërblimit e përfitojnë edhe personat, që aktivizohen në këshilla të përkohshme artistiko-kulturore, si juri a komisione të vlerësimit të veprave të artit. Këta persona shpërblehen në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje.

Efektet financiare, për shpërblimin e anëtarëve të këshillave artistiko-kulturore, të përballohen nga të ardhurat që krijon vetë institucioni.”.

6. Pas pikës 5, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Ngarkohet Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrë udhëzimin përkatës për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këshillave artistiko-kulturore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.1, datë 22.2.2005

PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË

MINISTRAVE “PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 dhe 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në ndarjen II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të udhëzimit nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 7 shtohen pikat, si më poshtë vijon:

“8. Periudha e garancisë për punimet e ndërtim-montimit në objektet, publike dhe jopublike, të përfunduara, fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve dhe zgjat nga një deri në dy vjet, gjë që përcaktohet në kontratë, për veprën në tërësi a për pjesë apo procese të veçanta, në varësi të llojit të objektit, kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së punimeve të kryera.

9. Investitori ose personi i autorizuar prej tij njofton zyrtarisht zbatuesin e punimeve për çdo difekt të ndodhur në vepër gjatë periudhës së garancisë. Zbatuesi është i detyruar ta ndreqë difektin brenda periudhës së garancisë dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM **Nr.68, datë 15.3.2005**

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 9.5.2003 “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.159, DATË 13.3.2003 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET, SI DHE PROCEDURAT E SHITJES”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedurat e shitjes”, Ministri i Ekonomisë

UDHËZON:

Pas pikës 1 të udhëzimit nr.1, datë 9.5.2003, bëhen këto shtesa:

“0.1 Miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private drejtohet dhe organizohet nga Ministri i Ekonomisë. Përrjashtimisht, miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private për pasuritë e luajtshme kryhet nga organi që i administron ato.

0.2 Përkufizime

1. “Pasuritë e luajtshme” do të konsiderohen: makineritë, pajisjet, inventari ekonomik dhe mjetet e xhiros, por jo linjat e prodhimit dhe të shërbimit, si dhe aksesorët që bëjnë të pamundur funksionimin e këtyre linjave.

2. “Organi që i administron ato” do të konsiderohen:

a) Për organet e qeverisjes vendore, konsiderohet: këshilli i qarkut, i bashkisë dhe i komunës;

b) Për institucionet qendrore, konsiderohet: titullari i institucionit qendror.
c) Për ndërmarrjet shtetërore të patransformuara, konsiderohet: këshilli drejtues i ndërmarrjes dhe kur nuk ka të tillë, miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private bëhet nga titullari i ministrisë së vartësisë administrative.

d) Për shoqëritë tregtare, konsiderohet: këshilli mbikëqyrës.

e) Për repartet ushtarake dhe komisariatet e policisë, konsiderohet: titullari i ministrisë përkatëse.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË
Anastas Angjeli

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 16.3.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë